Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Lavdim Fejza eks.shqyrtues/Teknik _____	*Data e autorizimit të ekspertit* 08.08.2022	*Data e dorëzimit të raportit* 15.08.2022	Nr. i lëndës: 303/ 22

Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 29.07.2022,OE ***"SFISHTA AUTOHOME"SHPK -Prishtinë***, ka parashtruar ankesë me nr:303/22, kundër njoftimit për dhenie të kontratë për aktiviteti e prokurimit: **"Shërbimet e Mirëmbajtjes se Automjeteve" me nr. te prokurimit 21432700-22-4769-2-2-1** , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia e Menaxhimit Emergjent "AME"**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: sherbime, vlera e parashikuar e kontratës:

–30,000.00 €

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 0-5/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore OE- ***"SFISHTA AUTOHOME"SHPK -Prishtinë***

OE "Sfishta Auto Home" Sh.P.K konsideron se AK AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT, gjate vlersimit, ekzaminimit dhe krahasimit te ofertave, per aktivitetin e prokurimit ne fjale: Sherbimit te mirembajtjes se automjeteve, me nr te prokurimit: 21432700-22-4769-2-2-1, ka bere keto shkelje te dispozitave ligjore:


Nenin 1. Qellimi.
Nenin 6. Ekonomiciteti dhe efikasiteti.
Nenin 7. Barazia ne trajtim / Jo-diskriminim.
Nenin 59. Pikat 2, 3 dhe 4 Ekzaminimi, vlersimi dhe krahasimi i tendereve.
Nenin 60. Pika 1, paragrafi 1.1 Kriteri per dhenie te kontrates.

Nga praktikat e mëhershme në të shumtën e rasteve nuk i kemi kalkuluar ofertat në bazë të peshimit. Formulari i tenderit nga AK nuk ka qenë i përpiluar për ta kalkuluar automatikisht cmimin e poentuar.
Ne konsiderojme se kalkulimi i poentuar ka mundur te behet dhe eshte pergjegjesi e komisionit te vleresimit. Meqenese ne rastin konkret mos kalkulimi i cmimit te poentuar te konstatuar nga AK? dhe i cili eshte marre si pretekst per eleminimin tone eshte ne kundershtim me dispozitat e cekura me larte, sepse ne rastin konkret cmimi i poentuar nuk ka asnje implikim tjeter ne oferten fmanciare perpos konstatimin e ofertes me te leverdishme.
Ne rastin konkret jemi eleminuar pa te drejte dhe jemi kanditati potencial per shperblim me kontrate meqenese ne raport me ofertat tjera te dorezuara kemi oferten me te lire.

Kriteret për vlerësim

Çmimin më te ulët

Raporti i komisionit vlerësues



DEKLARATË

Bazuar ne vendimin e Drejtorit te pergjithshem per caktimin ne komisionin e vleresimit dhe krahasimit te ofertave te operatoreve ekonomik konsttaojm se kan ofeertuar gjithsejt gjat< operator ekonomik.

Kriteri ne dosjen e tenderit ka qen ne baz e te LPP çmimi me i lir i përgjegjëshem.

Ne dosjen e tenderit ne pikën 30.1 ka qen i vendosur kriteri ne bazë te RROUP qe te vendoset çmimi me peshim dhe ne hapje do te lexohet qmimi me peshim.

Kurse 2 operator ekonomik nuk ka ofertuar konfoirm kriteri te dosjes se tenderit si dhe RROUP pasi qe te nejtit nuk kan vendosur ne oferten e tyre ne FDT dhe paramas çmimin me peshim ket vbeprim e ka ber OE:

1.GR.OE SFISHTA SHPH & AUTO HOME SHPK
2.NTSH BESI

bazuar ne ket ekonstatojm dhe vleresojm qe keta dy operator jan te pa pergjegjeshme kurs eoperatoret tjer jan konform kerkesave te dosjes se tenderit po bazuar ne kriterin e dhenies qmimi me i ulet rekomandojm per dheni operten e operatorit ekonomik

1.GR.OE AHM SERVICE SHPK & Mihrije Lahu B.I me qmimin me te lir te pergjegjshem

11

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Me datën 29.07.2022,OE ''SFISHTA AUTOHOME"SHPK - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr:303/22, kundër njoftimit për dhenie të kontratë për aktiviteti e prokurimit: "Shërbimet e Mirëmbajtjes se Automjeteve" me nr. te prokurimit 21432700-22-4769-2-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia e Menaxhimit Emergjent "AME"

Informacionet shtesë të marra me anë të sqarimeve të kërkuara nga ana e ekspertëve shqyrtues dhe /ose teknik

N/A

Vlerësimi sipas nenit 4.1.26 tëLPP-së

N/A

Vendimet e mëparshmetëPSH-së,lidhur me rastet e ngjashme

(Të sqarohet nësepër rastin e njëjtë është dhënëvlerësimtjetër).

Arsyetimi për devijim nga praktika e mëparshme

N/A

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE **–** ***"SFISHTA AUTOHOME"SHPK -Prishtinë***

•Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / AK-AME**,** gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbime. **Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhenie kontratë të aktivitetit të prokurimit.**

Përgjigjie ne Pretendimi ankimor 1.

Ekpserti shyrtues vlersone se autoriteti kontraktue në FDT në pikën 30.1 Kriteret e dhënies – ka potencuar se operatoret ekonomik apo tenderuesit në oferten e tyre të vendosin çmimi total i poentuar (peshuar), andaj ne këto raste ne hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qellim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Ndësra operarori ekonomi ankues në oferten e tije të ofruar në Formularin për dorëzimin e tenderve si dhe ne paramasen " lista e çmimeve " ka nuk ka vendosuar çmimi total i poentuar (peshuar) e cila nuk është në pajtim me kërkesa e autoriteti të kërkuar ne FDT. Po ashtu edhe sipas Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik neni 56.15 Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qellim të vlerësimit të

ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës ne këto raste duhet të përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime të raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (vetem për riparime dhe mirëmbajtje).

Kërkesa e autoriteti kontraktues e vendosur në FDT.

Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët** ☒ apo Tenderi i përgjegjshëm **ekonomikisht më i favorshëm i** përcaktuar sipas kriterit të peshës të përshkruar në Aneksin 6 ☐

Formular për dorëzimin e tenderit – e operatorit ekonomik ankues.

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 21432700-22-4769-2-2-1

Titulli i kontratës: Shërbmet e Mirëmbajtjes se Automjeteve

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Shërbmet e Mirëmbajtjes se Automjeteve

3. Çmimi total i tenderit është:

54 199,64 EUR

Dhe në fjalë [*shëno çmimin e tenderit në fjalë* ***Euro***]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet*] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [*shëno emrin e udhëheqësit*]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Me datën 29.07.2022,OE ''SFISHTA AUTOHOME"SHPK - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr:303/22, kundër njoftimit për dhenie të kontratë për aktiviteti e prokurimit: "Shërbimet e Mirëmbajtjes se Automjeteve" me nr. te prokurimit 21432700-22-4769-2-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia e Menaxhimit Emergjent "AME"

Lista e çmimeve te operatorit ekonomik ankues.

LOT-1, R E K A P I T U LL I M I :					
			Gjithsej, Çmimi per njësi i ofertës me TVSH, pa peshuar në bazë të rëndësisë në €		Peshimi i Çmimit sipas rëndësisë
A	Nën totali A, :		865.08		50%
B	Nën totali B, :		34,340.56		35%
C	Nën totali C, :		6,760.00		10%
D	Nën totali D, :		12,234.00		5%
	T O T A L (A + B + C + D) :		54,199.64		100%

Po ashtu kemi dhe interpretimin e KRPP-së pika 59 të datës 23.07.2018 citoje:

59. 23.07.2018. Për veç "kategorive të shërbimeve", a mund të përdoret çmimi më i ultë me poentim (në bazë të nenit 52.6 të LPP-ës, dhe neneve 56.11 dhe 18.28 të RUOPP) edhe për kategori tjera në prokurimit publik? (Referoju RRUOPP)

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në të dhënat e shkresës tuaj, KRPP, ofron interpretimin ligjor si në vijim:.

Neni 52.6 i LPP-ës, sa i përket çështjes së lartë përmendur përcakton si në vijim.

*"Në rast të kriterit, tenderi me çmimin më të ulët nuk lejohet konvertimi i çmimeve në pikë dhe të peshohen pikët. Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose **në rast të kontratave me çmime për njësi**, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës **"kategori të shërbimeve"** ose **secilit "artikull"** në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët...".*

Për të njëjtën çështje flet edhe neni 18.28 i RUOPP. Sipas këtij neni:

*"Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, **kontratat me çmime për njësi**, AK duhet te përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "**kategori të shërbimeve**" ose **secilit "artikull"** ose "grup te artikujve" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët ne baze te poentimit**, si p.sh. mirëmbajtje te veturave , mirëmbajtje te gjeneratorëve etj."***

Ndërsa neni 56.11 i RUOPP, çështjen e lartë përmendur e rregullon si në vijim:

"*Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasite indikative,* ***kontratat me çmime për njësi****, AK duhet te përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "****kategori të shërbimeve****" ose secilit* ***"artikull"*** *në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Ne këto raste nuk vlen pargu apo tavani* ***plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje te veturave , mirëmbajtje te gjeneratorëve etj.*** *Ne këto raste ne hapje publike te ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qellim te vlerësimit te ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit te ekzekutimit te kontratës ne këto raste duhet te përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime te raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës*."

Bazuar në dispozitat e lartë cituara, KRPP, konsideron se neni 52.6 i LPP-ës, si dhe nenet 56.11 dhe 18.28 të RUOPP përveç kategorisë së shërbimeve mund të përdoren edhe te llojet e tjera të kontratave, kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasitë indikativë dhe konsideron se me përdorimin e këtyre dispozitave respektohet qëllimi kryesor i këtij ligji i përcaktuar në nenin 1 paragrafin 1.

Ndërsa, për peshimin e artikujve apo grupeve te artikujve, vendosjen e tyre në kategoritë përkatëse, si dhe mos përsëritjen e tyre mbetet përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues.

Eksperti shqyrtues vlerson se duke u bazuar ne sqarimet e lartpërmendura autoriteti kontraktues, ka vepruar conform neni 1, neni6, neni7, neni 59, neni 60 gjatë procesit për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, si dhe të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues është e pa bazuar, të mbetët në fuqi vendim njoftim për dhenie të kontratës.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **AME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP-së.**
- OE ankues - ***"SFISHTA AUTOHOME"SHPK -Prishtinë***